



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË PROVËS

# R A P O R T

Janar - Shkurt 2022

Raport Muji

## **PËRMBAJTJA**

**Lënda**

**Faqe**

**Përmbajtja**

### **I. Statistika**

**(3 - 6)**

1. Numri i personave të dënuar me dënime alternative të dhëna nga gjykata për periudhën Janar - Shkurt 2022
2. Numri i personave të dënuar me dënime alternative për të cilët ka përfunduar periudha e provës, për të cilët është dhënë vendimi i pushimit nga prokuroritë për periudhën Janar - Shkurt 2022
3. Numri total i personave të dënuar me dënime alternative që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës të rritur/ të mitur
4. Numri mesatar i personave të dënuar me dënime alternative që mbikëqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe degë territoriale.
5. Raportet e Vlerësimit me kërkesë të gjykatës dhe prokurorisë.

### **II. Bashkëpunimi me partnerët**

**(6)**

- Me Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, gjykatat, prokuroritë dhe organet e pushtetit qendror e vendor,
- Me OJF-të.

### **III. Problematikat e punës**

**(6 -7)**

## I nderuar Zoti Ministër,

Mbështetur në nenin 8, pika 1 germa b), të Ligjit nr. 78/2020 “Për “Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës”, po Ju paraqesim raportin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës për periudhën Janar – Shkurt 2022.

Bazuar në urdhrin nr. 55, datë 20.04.2017, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës” i ndryshuar. Shërbimi i Provës ka **22** Zyra Vendore me vendndodhje në qytetet Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Shkodër, Gjirokastër, Lezhë, Korçë, Berat, Mat, Kukës, Vlorë, Krujë, Lushnjë, Dibër, Kavajë, Kurbin, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë dhe Tropojë.

### I. Statistika

Për periudhën Janar - Shkurt 2022, volumi i punës së kryer nga Shërbimi i Provës ka ardhur në rritje, numri i të dënuarve me dënime alternative që specialistët mbikëqyrin, kërkesat nga gjykatat dhe prokuroritë për raporte vlerësimi janë në rritje të vazhdueshme. Disa nga statistikatat dhe paraqitjet që pasqyrojnë punën që ka kryer e po kryen institucioni do të jepen me anë të të dhënave si më poshtë:

#### 1. Numri i personave të dënuar me dënime alternative të dhëna nga gjykatat për periudhën (01.01.2022 – 28.02.2022).

Gjatë periudhës Janar - Shkurt 2022, kanë ardhur pranë Zyrave Vendore **1080** urdhra ekzekutimi nga prokuroritë, që do të thotë se ngarkesës aktuale të mbikëqyrjes do ti shtohen dhe **1080** persona të dënuar. Këto të dhëna jepen si më poshtë:

#### Persona të dënuar shtesë në mbikëqyrje nga Shërbimi i Provës për periudhën (01.01.2022 – 28.02.2022).

##### ➤ Tabela 1.

| Lloji i dënimeve alternative         | Janar      | Shkurt     | TOTALI      |
|--------------------------------------|------------|------------|-------------|
| Neni 59 i KP, Pezullimi              | 372        | 515        | 887         |
| Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi   | 0          | 3          | 3           |
| Neni 64 i KP, Lirimi me kusht        | 4          | 12         | 16          |
| Neni 63 i KP, Punë në interes publik | 73         | 101        | 174         |
| Neni 58 i KP, Gjysmëliria            | 0          | 0          | 0           |
| <b>TOTALI</b>                        | <b>449</b> | <b>631</b> | <b>1080</b> |

**2. Numri i personave të dënuar për të cilët ka përfunduar periudha e provës për periudhën (01.01.2022 – 28.02.2022).**

➤ **Tabela 2.**

| Lloji i dënimeve alternative         | Janar      | Shkurt     | TOTALI     |
|--------------------------------------|------------|------------|------------|
| Neni 59 i KP, Pezullimi              | 290        | 424        | <b>714</b> |
| Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi   | 2          | 7          | <b>9</b>   |
| Neni 64 i KP, Lirimi me kusht        | 7          | 21         | <b>28</b>  |
| Neni 63 i KP, Punë në interes publik | 56         | 76         | <b>132</b> |
| Neni 58 i KP, Gjysmëliria            | 0          | 1          | <b>1</b>   |
| <b>TOTALI</b>                        | <b>355</b> | <b>529</b> | <b>884</b> |

**3. Numri total i të dënuarve me dënime alternative që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës (datë 01.01.2022 –28.02.2022).**

Numri total i personave të dënuarve që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës është **8126** persona të dënuar.

I ndarë sipas llojeve të dënimeve alternative, ky informacion jepet si më poshtë:

➤ **Tabela 3.**

| Lloji i dënimeve alternative         | Të rritur   | Të mitur   | Totali në mbikëqyrje |
|--------------------------------------|-------------|------------|----------------------|
| Neni 59 i KP, Pezullimi              | 6988        | 157        | <b>7145</b>          |
| Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi   | 48          | 1          | <b>49</b>            |
| Neni 64 i KP, Lirimi me kusht        | 303         | 0          | <b>303</b>           |
| Neni 63 i KP, Punë në interes publik | 601         | 21         | <b>622</b>           |
| Neni 58 i KP, Gjysmëliria            | 7           | 0          | <b>7</b>             |
| <b>TOTALI</b>                        | <b>7947</b> | <b>179</b> | <b>8126</b>          |

**4. Numri mesatar i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe zyre vendore.**

Sa më sipër duke ju referuar numrit total të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës prej **8126** të dënuarish, numri mesatar i të dënuarve që mbikëqyren nga një punonjës në nivel vendi aktualisht është **94**. E shprehur kjo për çdo zyrë vendore është si më poshtë:

➤ **Tabela 4.**

| DEGËT TERRITORIALE                                  | Totali të rritur | Totali të mitur | TOTALI      | Numri i Specialisteve | Te mbikeqyrur për specialist |
|---|------------------|-----------------|-------------|-----------------------|------------------------------|
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Tiranë      | 1630             | 39              | 1669        | 25                    | 67                           |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Durrës      | 540              | 30              | 570         | 5                     | 114                          |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Fier        | 971              | 14              | 985         | 7                     | 141                          |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Shkodër     | 774              | 12              | 786         | 8                     | 98                           |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Lezhë       | 179              | 1               | 180         | 6                     | 30                           |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Elbasan     | 513              | 6               | 519         | 4                     | 130                          |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Korçë       | 306              | 14              | 320         | 3                     | 107                          |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Gjirokastrë | 187              | 2               | 189         | 2                     | 94                           |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Mat         | 62               | 1               | 63          | 1                     | 63                           |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Vlorë       | 562              | 14              | 576         | 4                     | 144                          |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Berat       | 640              | 25              | 665         | 4                     | 166                          |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Kukës       | 177              | 4               | 181         | 2                     | 90.5                         |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Pogradec    | 132              | 1               | 133         | 1                     | 133                          |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Lushnjë     | 266              | 2               | 268         | 4                     | 67                           |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Kurbin      | 248              | 0               | 248         | 1                     | 248                          |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Krujë       | 248              | 2               | 250         | 2                     | 125                          |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Pukë        | 20               | 1               | 21          | 1                     | 21                           |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Sarandë     | 152              | 4               | 156         | 2                     | 78                           |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Kavajë      | 128              | 4               | 132         | 1                     | 132                          |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Dibër       | 133              | 2               | 135         | 1                     | 135                          |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Tropojë     | 54               | 0               | 54          | 1                     | 54                           |
| Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Përmet      | 25               | 1               | 26          | 1                     | 26                           |
| <b>TOTALI</b>                                       | <b>7947</b>      | <b>179</b>      | <b>8126</b> | <b>86</b>             | <b>94</b>                    |

## 5. Raportet e Vlerësimit me kërkesë të gjykatës dhe prokurorisë.

Konkretisht për Periudhën Janar – Shkurt 2022:

- ❖ Janë kërkuar nga gjykatat **78** raporte vlerësimi për persona të pandehur;
- ❖ Janë kërkuar nga prokuroritë **41** raporte vlerësimi për persona nën hetim ;
- ❖ Kanë ardhur **1080** urdhra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët **27** urdhra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për ta.
- ❖ Ka përfunduar mbikëqyrja për **884** persona të dënuar me dënime alternative .

## II. Bashkëpunimi me partnerët.

### - *Me partnerët.*

Ecuria e bashkëpunimit të Shërbimit të Provës me partnerët si: Policia e Shtetit, gjykatat, prokuroritë dhe pushtetin vendor ka qenë në vazhdimësi në përputhje me qëllimin e bashkëpunimit.

Më datë 17.03.2022, u lidhë marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Bashkisë Tiranë “ Për sigurimin e kuadrit infrastrukturor dhe institucional për zbatimin e masave alternative të shmangies nga ndjekja penale për të miturit në konflikt me ligjin”

### - *Me OJF-të*

Gjatë periudhës Janar –Shkurt 2022 ka vazhduar normalisht bashkëpunimi i degëve territoriale me OJF-të, sipas marrëveshjeve që janë nënshkruar lidhur me trajtimin e rasteve të mbikëqyrjes për të dënuarit me dënime alternative, por në disa degë ka nevojë për përmirësim, lidhur me mungesën e një organizate që ndihmon në trajtimin dhe rehabilitimin e të dënuarve të cilët kanë varësi nga drogat ose alkoli.

## III. Problematika e punës.

- Adresat të pasakta nga gjykatat dhe prokuroritë, të cilat nuk bëjnë të mundur njoftimin e të dënuarit për t’u paraqitur pranë Z.V.SH.P-ve.
- Mangësi të shfaqura në vendimin e gjykatës (pengesa në fillimin dhe vazhdimin e procedurave),
- Mos kthimi i përgjigjeve të kërkesave drejtuar Prokurorive , duke përfshirë kërkesat për informacion, raportet e mospërbushjes, raportet përfundimtare duke sjelle në këtë mënyrë vështirësi në zbatimin e detyrave funksionale.
- Shërbimi postar sjell vonesa në kthimin e korrespondencave brenda afateve kohore.
- Mungesa e Burimeve Njerëzore (kapaciteteve) në disa Degë Territoriale
- Mungesa e një ambjenti funksional, në disa Degë Territoriale
- Trajnimet e pamjaftueshme (Ndërtimi i kapaciteteve)

- Mungesa e qendrave për trajtimin e personave të dënuarve varësi nga lëndët narkotike, drogërat e forta ose alkoli
- Mungesa e qendrave për trajtimin psikologjik të dhunës në familje.
- Mungesa e infrastrukturës për trajtimin psikologjik të të miturve në konflikt me ligjin dhe familjarëve të tyre,
- Rritja e nivelit të pagës,
- Nevojë imedjate për ristrukturim.

Duke shprehur se analiza e punës së kryer nga Shërbimi i Provës si dhe problematikat e hasura janë pasqyruar me objektivitet, Ju sigurojmë se zbatimi i të gjithë detyrave funksionale, rritja e nivelit dhe e profesionalizmit do të jenë prioritete të punës sonë edhe në të ardhmen.

Me respekt,

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**Ervin Hoxha**

Koc: Teuta Shehu  
Specialist, DF&SHM  
Datë: 18.03.2022  
Nr.kopjeve 2